



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kadastrit
Periudha raportuese	Muaji janar, 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në Drejtorinë e Kadastrit, për muajin raportues.

Drejtoria e Kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës, ka vazhduar me ofrimin e shërbimeve sa me efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit janar, në 5 zyrat pritëse janë pranuar gjithsejtë **2011** kërkesa, nga të cilat janë miratuar **1984** kërkesa, janë refuzuar **10** dhe kanë mbetur në procedurë edhe **38** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes 2 sektorëve: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Aktivitetet e parapara sipas planprogramit të Komunës për Drejtorinë e Kadastrit, për muajin raportues:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastralë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;

- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisve banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

3. *AKTIVITETET E REALIZUARA*

Aktivitetet e zbatuara dhe ato në zbatim e sipër, gjatë periudhës raportuese, në Drejtorinë e Kadastrit.

Në Drejtorinë e Kadastrit gjatë muajit janar 2016, përmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve, Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë, janë pranuar kërkesa të ndryshme.

Në Sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:

- **298** kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë miratuar **267** (20 kërkesa të ngelura në procedurë nga muajt e kaluar), janë refuzuar **10** kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me **21** konkluzione, duke u pezulluar procedura deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse;
- **20** kërkesa për përmirësime, nga të cilat 18 janë miratuar, ndërsa 2 janë në procedurë;
- **43** kërkesa për regjistrim të hipotekave dhe **37** kërkesa për çregjistrim, nga të cilat janë miratuar të gjitha;
- **14** kërkesa për barra tatimore, janë miratuar në tërësi;
- **289** shkresa dhe kërkesa nga institucionet e ndryshme, janë realizuar të gjitha nga shërbimi i RDPP-së;
- **10** kërkesa për historik nga persona fizikë dhe institucione, janë miratuar të gjitha.

➤ Në Sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:

- **655** kërkesa për certifikata të pronësisë, ndërsa **490** kërkesa për kopje të planit, në total **6372**;
- **13** kërkesa për ndarje të pronësisë, nga të cilat janë miratuar **10** (3 nga muaji i kaluar), ndërsa **6** janë në procedurë;

- 8 kërkesa për bashkim të parcelave, nga të cilat janë miratuar 7 kërkesa (1 nga muaji i kaluar), ndërsa 2 kërkesë janë në procedurë;
- 47 kërkesa për dhënien e produkteve (koordinatave), janë realizuar të gjitha;
- 37 kërkesa për identifikimin e njësisve banesore, janë miratuar 39 (2 nga muaji i kaluar);
- 10 kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri, nga të cilat janë miratuar 10 (3 nga muaji i kaluar) dhe 3 kërkesa janë në procedurë;
- 22 kërkesa nga gjeodetë dhe kompani të licencuara, nga të cilat janë miratuar 31 (10 nga muaji i kaluar), 1 kërkesë është në procedurë;
- 17 kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet, si: Ministria e Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Urbanizmit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj., nga të cilat janë miratuar 16 (2 nga muaji i kaluar), ndërsa 3 janë në procedurë.
- 1 kërkesë për ndërrim kulture , e miratuar.

Nga kjo shihet se Drejtoria e Kadastrit ka zbatuar gati 90 për qind (%) të planit të saj, duke i miratuar, refuzuar apo pezulluar kërkesat e palëve në procedurë, sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa. E arritur e kësaj drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve, ka arritur të nxjerrë vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët/subjektet fizike dhe juridike.

4. AKTIVITETET NË ZBATIM E SIPËR

Aktivitetet në zbatim e sipër nga Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike, në afat prej 5 ditë pune, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në Operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA, verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, Arkiv komunal ose ndër komunal.

Aktivitetet që janë në zbatim e sipër nga Sektori i gjeodezisë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;

- Lëndët për identifikimin e njësive banesore;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

4.1.1. STATISTIKAT - Statistikat përkatëse, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit, janar 2016	Numri i kërkesave	Të miratuar	Të refuzuar	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara - €
Certifikata të pronësisë dhe kopje të planit	1,145	1145	0	0	6,372
Vërtetim për nevoja personale (aplikim për vizë, bursa etj.)					
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i së drejtës për pronë të paluajtshme)	298	267	10	21	9.240
Kërkesa zyrtare për historik, historik për persona fizikë dhe juridikë	10	10	0	0	150
Kërkesa nga institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga gjykatat dhe institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së	289	289	0	0	40
Përmirësime në RDPP	20	18	0	2	400
Barra tatimore	14	14	0	0	270
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	43	43	0	0	4,580
Kërkesa për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	37	37	0	0	380
Ndarjet - parcelimet, copëtimet	13	10	0	6	912.80

Incizimi i ndërtesave, banesave					
Bashkimi i parcelave	8	7	0	2	250
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	47	47	0	0	2.416
Identifikimi i parcelave dhe njësive banesore	37	39	0	0	740
Përcaktimi dhe rirregullimi i kufirit të parcelave	10	10	0	3	700
Ndërrim i kulturës	1	1	0	0	414
Plotësim pagese - gjeodezi					
Kërkesa me licencë	22	31	0	1	2,315
Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë	17	16	0	3	0
Gjithsej	2,011	1,984	10	38	29.179 euro

4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për periudhën raportuese

Drejtoria e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastralë, përkundrazi, realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

4.1.3. Takimet me palë

1. **Spektori i kadastrit**, gjegjësisht Zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP), ka takime të rregullta me palë, dy herë në javë (*të martën dhe të enjten*) nga 2 orë në ditë, me dy zyrtarë ligjorë, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palëve. Brenda këtyre 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP-së, takohen mesatarisht me **324** qytetarë.
2. **Spektori i gjeodezisë** ka takime të rregullta me palë, ku gjatë muajit janar ka pranuar **300** palë për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Ka takime me palë për identifikimin e banesave dhe takime të tjera me palë, sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

5. Takimet me institucione të tjera

- **Sektori i kadastrit** mban takime me qytetarët për çështje të ndryshme kadastrale - pronësore për të cilat ka pasur zgjidhje ligjore, ose i kemi udhëzuar palët që t’u drejtohen institucioneve të tjera në vend.
- Takim me AKP-në për disa përgjigje të kthyer nga kjo agjenci.

6. *Diskutime publike/Takimet me qytetarë*

- Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kemi pasur diskutime publike - takime me qytetarë.

6.1.1. *Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare*

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur vetëm një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare nga gazeta “BIRN”.

6.1.2. *Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër*

- **Sektori i kadastrit:**
 - Lëndë të pranuar 711
 - Lëndë të kryera 678
 - Lëndë të refuzuara 10
 - Lëndë në procedurë..... 23
- **Sektori i gjeodezisë:**
 - Lëndë të pranuar 1300
 - Lëndë të kryera 1306
 - Lëndë të refuzuara 0
 - Lëndë në procedurë 15

Vërejtje: 21 lëndë të kryera nga muajt e kaluar.

7. *Takime të tjera*

8. *SFIDAT*

Sektori i kadastrit:

- Sfidues është komunikimi me institucionet, mospërgjegjet e tyre në afate ligjore, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.

Spektori i gjeodezisë:

- Sfidues mbetet komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, mospërgjegjet e tyre në lidhje me problemet që hasim çdo ditë me programin CadastralMap dhe SITK, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruktimit të disa zonave kadastrale nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

9. REKOMANDIME

Spektori i kadastrit:

- Trajnime për punëtorë sa i përket administratës dhe funksionimit të saj.

Spektori i gjeodezisë:

- Trajnime për punëtorë sa i përket aplikimit të Kornizës së punës,
- Furnizim me printerë me ngjyra,
- Furnizim me një skaner, i cili do të na ndihmonte mbarëvajtjen e punës.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Spektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike, në afat prej 5 ditë punë;
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët për verifikim në gjykata, Arkiv komunal ose ai ndërkomunal.

Spektori i gjeodezisë:

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësive banesore;

- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët apo kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

11. TË TJERA

- Kërkesa në Agjencinë Kadastrale të Kosovës për dhënien e një përdoruesi (*user*) të ri, në mënyre që të mundësohet hapja e një sporteli të ri për eliminimin e radhëve të gjata të qytetarëve para sporteleve në Drejtorinë e Kadastrit.